

KUVENDI KOMUNAL – DRAGASH

01.Nr .016-107

22.06.2008

D r a g a s h

Në bazë të nenit 88. të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 të 20. Shkurt 2008 , Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare me nr. 2003/12 dhe Statutit të komunës së Dragashit ,pas shqyrtimit paraprak ,Kuvendi i komunës të Dragashit , në seancën e mbajtur më datën 04.12.2008 ,miraton këtë:

**RREGULLORE**  
**PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE PËR KONSULTIM DHE PJESËMARRJE**  
**TË PUBLIKUT NË VENDIMARRJE**

**I. Dispozitat e përgjithshme**

Neni 1.

**( Qëllimi )**

Kuvendi i Komunës miraton këtë Rregullore me qëllim të zbatimit të dispozitave përkitazi me konsultimin dhe pjesëmarrjen e publikut të parashtruar në Ligjin për vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 të datës 20.02.2008 , Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare Nr.2003/12 dhe dispozitave të Statutit të Komunës së Dragashit , me qëllim të garantimit të drejtave të qytetarëve për tu informuar dhe për të marr pjesë në jetën politike të komunës.

Neni 2.

**(Fushë veprimtaria )**

Kjo Rregullore ka të bëjë me mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij të cilat janë të hapura për publikun përkitazi me mbledhjet ,me pjesëmarrjen e publikut gjatë mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij , si dhe me informacionet e Qeverisë që duhet ti vihen në dispozicion publikut.

Rregullat dhe procedurat e tjera plotësuese mund të vendosen në Rregullore tjera.

Neni 3.

**(Përkufizimet )**

Sipas kësaj Rregullore termat vijuese kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë :

**“Pjesëmarrje e publikut”** – do të thotë involvimi i banorëve të komunës në marrje të vendimeve të Pushtetit Lokal.

**“Takimet me publikun”** – janë takime të organizuara nga kuvendi komunal dhe organet e tij me qëllim të informimit të qytetarëve për aktivitetet e komunës ,në një të anë dhe parashtruesve të pyetjeve , dhënien e propozimeve dhe ngritjen e çështjeve me interes publik nga qytetarët për përfaqësuesit e zgjedhur komunal në anën tjetër.

**“Petition”** - Kërkesë me shkrim që i adresohet komunës ,gjegjësisht Kuvendit komunal nga i cili çdo person apo ndërmarrje që ka interes në komunë për çfarëdo çështje që lidhet me kompetencat dhe funksionet e komunës ,me qëllim që ajo të ndërmarr ndonjë veprim ose të përmbahet nga marrja e ndonjë veprimi.

**“Qasje në dokumentet zyrtare”** – nënkupton shikimin e dokumenteve zyrtare në pajtim me Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare

#### Neni 4.

##### **Mbledhje e hapura të Kuvendit dhe të Komiteteve të tij**

4.1. Në pajtim me nenin 45. të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale , të gjitha mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe të Komiteteve të tij rrjedha normale , janë të hapura për publikun duke i përfshirë edhe përfaqësuesit e shtypit .

4.2 . Në rast se Kuvendi i komunës vendos që ndonjë mbledhje ta mbyll për publikun , në pajtim me nenin 45.3. të Ligjit për vetëqeverisjen lokale , duhet të paraqes njoftim publik si dhe të jap shpjegime lidhur me marrjen e vendimit të tillë.

4.3. Kuvendi i komunës me Statut mund të themeloj rregulla për mbajtjen e seancave të mbyllura.

#### Neni 5.

##### **Përdorimi i gjuhës**

5.1 . Përdorimi i gjuhëve në Kuvendin komunal duhet të bëhet në pajtim me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve ,Statutin komunal dhe Rregulloren komunale të detajuar për përdorimin e gjuhëve.

5.2. Qytetarët mund të kërkojnë informata , dokumente dhe konsulta në gjuhën e zgjedhur , pa ndryshime.

#### Neni 6.

##### **Informimi publik për takime**

6.1. Komuna mban së paku 2 .herë në vit ,takime publike në të cilat pjesëmarrja e publikut dhe ndërmarrjeve me interes për komunën është e lejuar.

6.2. Njoftimi i publikut për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të komunës dhe të Komiteteve duhet bërë së paku 7.(shtat) ditë pune para mbledhjes , për mbledhjet e jashtëzakonshme 3.ditë . kurse për takimet publike të komunës 2.(dy) javë para mbledhjes.

6.3. Njoftimet publike për mbledhjet bëhet me shkrim dhe ai përmban : datën , kohën , vendin , rendin e ditës që i thekson çështjet që do të diskutohen , mandej një përshkrim të shkurtër të pikave të rendit të ditës , si dhe të gjitha të dhënat lidhur me publikimin e rendit të ditës.

6.4. Njoftimi publik afishohet në tabelën e afisheve në ndërtesën e Kuvendit komunal , emitohet në radio lokale dhe publikohet ne Web-faqen e komunës.

6.5 . Komuna është e obliguar që të lejoj kontrollimin e çfarëdo dokumenti që kërkohet nga qytetarët ,përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar me Ligjin mbi qasjen në dokumentacionin zyrtar.

## **II. Pjesëmarrja e qytetarëve në takimet publike**

### **Neni 7.**

#### **Takimet Publike**

7.1 Procedura që duhet ndjekur në takimet publike i përcakton Kryetari i Komunës i cili do të jetë kompetent për moslejimin e diskutimit të çështjeve që nuk lidhen me përgjegjësit ose kompetencat e komunës ose me drejtimin e punëve komunale , për kundërshtimin e dhënies së fjalës për të mos i dëgjuar folësit që paraqesin pikëpamje të ngjashme ose të përsëritura dhe për të vendosur kufizime të përgjithshme të kohës së lejuar për fjalime.

7.2. Takimet publike mbahen së paku dy herë në vit , njëra në gjashtëmujorin e parë të punës dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë. Varësisht nga nevoja Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij mund të organizoj edhe takime tjera publike .

7.3. Kryesuesi ose përfaqësuesi i tij cakton procedurat që duhet përndjekur gjatë takimeve si diskutimet , gjatësia e diskutimit dhe tema që trajtohen .

### **Neni 8.**

#### **Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve**

8.1. Për çdo rend dite t' ditës të mbledhjes së Kuvendit apo Komiteteve , publikut duhet ti afrohet mundësia që të bëjë vërejtje dhe të parashtrij pyetje përkitazi me secilën pikë të rendit të ditës ,para se kuvendi të marr çfarëdo vendimi lidhur me pikën përkatëse.

8.2. Një kufizim i arsyeshëm kohor do të caktohet për vërejtjet dhe pyetjet e publikut lidhur me secilën temë dhe se kufizimi i tillë do të figuroj edhe në rend të ditës.

8.3. Kufizimi i arsyeshëm kohor do të përcaktohet duke u mbështetur në natyrën rutinore ose kundërthënëse të temës , shkallën e interesimit të shprehur nga publiku për temën , ndikimin që do të ketë për anëtarët e publikut si dhe ngutshmerinë kohore të çështjes për tu vendosur.

#### Neni 9.

9.1. Anëtarët e publikut të cilët donë ti drejtohen Kuvendit të komunës ose Komiteteve të tij duhet të parashtroj një kërkesë me shkrim te Kryesuesi i Kuvendit të komunës së paku 1. orë para mbledhjes, duke potencuar temën për të cilën personi në fjalë dëshiron të flas.

9.2. Kryesuesi i Kuvendit të komunës e fton anëtarin nga publiku që ka parashtruar kërkesën me shkrim që ti drejtohet Kuvendit ose komiteteve të tij dhe i lejon fjalimin e tij në kohën e përcaktuar në rend të ditës.

9.3. Kryesuesi i Kuvendit mund ta kufizoj kohën për çdo folesë 3 (tre) minuta .

9.4. Kryesuesi mund ta kufizoj kohen e tillë edhe ma pak se 3(tre) minuta kur diskutohen qeshjet e përsëritura , kur ka fjalim polemizues ,shpifës ose imitues që rrezikon prishjen e mbledhjes.

9.5. Kohëzgjatja e përcaktuar në rend të ditës për vërejtje dhe pyetje të publikut mund të zgjatet nga Kryesuesi.

#### Neni 10.

Kohëzgjatja e përcaktuar në rend të ditës për vërejtje dhe pyetje të publikut mund të zgjatet nga Kryesuesi.

Kohëzgjatja nga alineja e sipërme lejohet:

- në rast se publiku tregon interesimin e tij për temën
- në rast se pikëpamjet e kundërta lidhur me temën nuk kanë pasur rast të dëgjohen në mënyrë të barabartë.

#### Neni 11

##### **Komitet Këshillëdhënëse**

11.1 . Në pajtueshmëri me dispozitat e Statutit komunal , Kuvendi i komunës themelon Komitete Këshillëdhënëse – sektoriale me qellim të përfshirjes qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

11.2. Vendimet e Komiteteve të kuvendit apo të Kuvendit të komunës duhet të merren vetëm pas konsultimit me Komitetin Këshillëdhënës sektorial , në pajtim me dispozitat e Statutit komunal.

Neni 12.

**E drejta e petitionit**

12.1. Qytetarët dhe organizatat kanë të drejtë e prezantimit të petitionit në Kuvendin e komunës për çfarëdo qeshte lidhur me kompetencat e komunës.

12.2. Kryesuesi i Kuvendi të komunës petitionet të bazuara në ligj duhet ti paraqesë Kuvendit të komunës brenda afatit 45. ditë,nga paraqitja e tij.

12.3. Kuvendi i komunës është i obliguar që ti shqyrtoj petitionet dhe të marr vendim brenda afatit prej 45. ditësh nga paraqitja e tij.

12.4. Vendimi i kumtohet paraqitësit të petitionit menjëherë së bashku me arsyetimin.

12.5. Qytetarët kanë të drejtë të vazhdojnë ta arsyetojnë qëndrimin e tyre. Nëse dështon kërkesa e parë për petition,qytetarët kanë të drejt ta përsërisin kërkesën e refuzuar.

Neni 13.

13.1. Peticioni duhet të përmbaj :

- emrin dhe mbiemrin si dhe adresën e parashtruesit ,
- emrat , mbiemrat dhe adresat e nënshkruesve të petitionit dhe
- lëndën e petitionit në secilën listë të nënshkruesve të petitionit

13.2. Peticioni përmban edhe të gjitha të dhënat relevante dhe informative që mund ta ndihmojnë kuvendin lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen meritore.

Neni 14.

**Iniciativat qytetare**

14.1. Qytetarët mund të ndërmarrin iniciativë për të propozuar projekt-rregulloret brenda kompetencave të komunës ,për miratim nga Kuvendi i komunës.

14.2. Propozuesi i projekt-rregullores të njëjtën ia dorëzon Kryesuesit të Kuvendit të komunës.

14.3. Draft-rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga ma së paku 15% e votuesve të regjistruar në komunë për tu shqyrtuar nga Kuvendi i komunës.

14.4. Kuvendi i komunës është i obliguar ta shqyrtoj Rregulloren në fjalë brenda afatit 60 ditësh ,nga dita e pranimit

Neni 15.  
**Referendumi**

**15.1.** Qytetarët kanë të drejtën që rregulloret e miratuara nga Kuvendi i komunës ti nënshtrohen referendumit.

15.2. Kërkesa për referendum duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar dhe duhet të dorëzohet Kryesuesit të kuvendit komunal brenda 30. ditësh nga dita e miratimit të rregullores.

15.3. Kuvendi i komunës është i obliguar ta shqyrtoj rregulloren e propozuar brenda 60,ditësh pas pranimit.

**III.E drejta e publikut për tu informuar dhe shikuar dokumentet komunale**

Neni 16.  
**Qasja në dokumentet zyrtare**

16.1. Dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për qasje në dokumente zyrtare sigurojnë që çdo person që është banor i përhershëm i Kosovës mund të kontrolloj çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna ,përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas dispozitave të Ligjit mbi dokumentacionin zyrtar.

16.2. Dokumentet që mban komuna janë: Procesverbalet , rregulloret , standardet , procedurat , udhëzimet , shkresat , letërkëmbimet , dokumentet tjera të shkruara nga anëtarët e Kuvendit , mandej ato të shërbyesve civil , vendimet dhe planet e komunës , informacionet lidhur me buxhetin ,shpenzimet dhe pagat e shërbyesve civil , projekt-rregulloret , komunikatat zyrtare si dhe i gjithë dokumentacioni tjetër që ka karakter zyrtar në pajtim me Ligjin për qasjen në dokumentet zyrtare .

Neni 17.  
**Procedura e qasjes në dokumente zyrtare**

17.1. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare duhet të jetë e çart e adresuar , me saktësi të duhur dhe e protokolluar në zyrën e pranimit ,në mënyrë që ti mundësoj institucionit të identifikoj dokumentin. Organi komunal konfirmon pranimin e kërkesës parashtruesit.

17.2. Pjesëtarët e komuniteteve në pajtim me neni 4 të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve , kanë të drejtë që kërkesën për qasje në dokumentet zyrtare ta parashtrorjnë në gjuhën e tyre amtare

17.3. Organi komunal e ka për detyrë që ti përgjigjet kërkesës brenda afatit kohorë prej 15. ditësh , nga dita e paraqitjes së kërkesës.

17.4. Nëse dokumenti i kërkuar për shkak të veçantisë ose nevojës për konsultim nuk mund të sigurohet brenda afatit prej 15 ditësh , për këtë pala e interesuar duhet të informohet jo më vonë se 15 ditë . duke shpjeguar pamundësinë e përmbushjes së kërkesës për informim duke i potencuar arsyet dhe shkaqet e vonësës , duke caktuar mundësisht datën kur do të sigurohen dokumentet.

17.5. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk merr përgjigje ,apo merr përgjigje negative ai ka të drejtë të bëjë kërkesën konfirmuese te i njëjti organ duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit.

17.6. Organi kompetent ,brenda 15, dite të punës nga data e pranimit të kërkesës konfirmuese të parashtruesit , është i obliguar të lejoj qasjen në dokumentin zyrtar të kërkuar.

17.7. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesshëm , organi kompetent informon parashtruesin e kërkesës për mjete ligjore që ka dispozicion , si që janë ankesat dhe procedurat gjyqësore tek gjykata kompetente.

Neni 18.

### **Informacionet e organeve komunale në dispozicion për publikun**

**Organet komunale** nga dita kur hyn në fuqi kjo Rregullore , publikon një shpallje e cila duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e organo-gramit , orarin e punës , terminët në të cilat publiku mund ti kryej punë në drejtorit si dhe personin kontaktues. Tabela e shpalljeve adhurohet me ndryshime sipas rasteve dhe nevojës.

Neni 19.

Zëdhënësi i Kuvendit komunal ofron informata publikut lidhur me punën e të gjitha organeve të komunës.

Neni 20.

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i komunës.

**KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL,**

---

Lulzim Rifaj